



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

Nr: 104/02-31159

10.01. 2025

**Procesverbal nga Debati Publik- Puna e Kryetarit Ilazi të arriturat dhe sfidat për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2024**

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 68 pika 68.1, Statutit të Komunës, neni 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun organizuan takimin e parë publik me qytetarë

**Tema: Puna e Kryetarit Ilazi të arriturat dhe sfidat për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024**

**Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, në objektin e administratës**

**Data dhe koha: 26 qershor 2024 ( e enjte ) ; Ora: 14:00**

Fillimisht takimin e hapi Kryetari Besim Ilazi, i cili shpalosi raportin vjetor, për punët dhe aktivitetet komunale. Fillimisht Kryetari Besim Ilazi përshëndeti qytetarët dhe përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave dhe qytetarët e tjerë të pranishëm, duke i uruar ata me rastin e festave të fund vitit.

Në këtë takim kryetari prezantoi punët dhe aktivitetet komunale në secilin sektor gjatë vitit 2024. Fillimisht kryetari Ilazi ceku vështirësitë nga mos përkrahja e nivelit qendror, ndërsa shtoi se edhe këtë vit ka vazhduar realizimi i projekteve komunale në të gjithë sektorët. Në administratën komunale është duke u realizu projektin për rregullimin e qasjes për të gjithë pa dallime në objektin komunal. Në zhvillim të turizmit janë realizuar projektet rekreative në Shtrazë, ndërtimi i shkallëve për ngjitje tek Guri i Shpum ndërtimi i shtegut të lirisë, ( projekte në ndërtim e sipër), në bujqësi kemi shumfishuar shumën e premtuar për subvencione të fermerëve me mjete pune, kurse në shërbime publike kemi investuar në rrjet të kanalizimit, ujësjellësit, hapësira publike, asfaltim të rrugëve me infrastrukturën përcjellëse, ura, nënkalime etj. Kurse investime kemi bërë

edhe në shëndetësi, me rregullimin e infrastrukturës shëndetësore, me ndërtimin e objektit të QMF-së në Doganaj, ndërsa kemi përkrahur edhe familjet sociale, ku kemi pëzgjedhur 36 familje që do të bëhen me kulm mbi kokë.

Investime janë bërë edhe në infrastrukturën arsimore me rregullim të sallave të edukatës fizike, renovim të objekteve shkollore, digjitalizim të shkollave, ndërsa 41 student kanë përfituar bursa nga komuna.

Të pranishmit në debat, qytetarë e administrator të lagjeve dhe fshatrave përgëzuan komunën për punët dhe arritjet komunale, ndërsa paraqitën edhe kërkesat e lokaliteteve që ata përfaqësojnë.

**Flakron Tusha-** Ju përgëzoj për punët dhe të arriturat pavarësisht sfidave, unë kam pasur një kërkesë me i ftu përfaqësuesit e Klubit Lepenci dhe me debatu në lidhje me gjendjen e këtij klubi, pse nuk janë ftuar. Poashtu kërkoj që të bëhet digjitalizimi i Shkollës Fillore "Emin Duraku" e veçanërisht me projektor, si dhe kërkoj që të bëhet rregullimi i ndriçimit publik në disa lagje ku është dëmtuar.

**Nezir Luta:** Ivajë- A ka fonde emergjente për zhbllokim të rrugëve nga bora?

**Shabi Dullovi:** Biqec- kam vetëm lëvdata nga fshati Biqec po bëni punë të mrekullueshme, të përfundohet rruga alternative në Biqec.

**Xhevdet Hysa:** Drejtor i Shkollës Fillore "Agim Bajrami"- Ju falënderoj për investimin në shkollën tonë, ndërsa kërkojmë që të futet në listën e investimeve komunale edhe Salla e Edukatës Fizike në Stagovë.

**Kemajl Jaha:** Stagovë- Rruga nga Lagjja Teneq e deri në Stagovë ku ka arrit me procedura a planifikohet të fillohet me punime?

**Rrustem Zenuni:** Kërkoj që të asfaltohet një pjesë e mbetur e rrugës "Razim Hasaj" sepse tashmë është bërë rrugë e rëndësishme, si dhe asfaltimi i rrugëve në lagjen Vogliqi, lagje në dy rrugicva si dhe rruga Semajë Gaqkë.

Kryetari Ilazi së bashku me ekzekutivin komunal, dhanë përgjigje në të gjitha kërkesat, ndërsa përgjigje me shkrim do të jepet edhe përmes raportit të këtij takimi.

**Procesmbajtëse**

**Fatlume Guri Selimi**

**Zyra për Informim**

